

**LIGJI NR. 04/L-211**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE “ISTISNA’A” DHE MARRËVESHJA PËR AGJENCINË “ISTISNA’A” PËR FINANCIMIN E VAZHDIMIT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS MILLOSHEVË - MITROVICË, RRUGA M2, E LIDHUR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE “ISTISNA’A” DHE MARRËVESHJA PËR AGJENCINË “ISTISNA’A” PËR FINANCIMIN E VAZHDIMIT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS MILLOSHEVË - MITROVICË, RRUGA M2, E LIDHUR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

**Neni 1  
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë marrëveshjen Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshjen për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2.

**Neni 2  
Ratifikimi**

Ratifikohet Marrëveshja Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2, e nënshkruar më 22.05.2013 në Dushanbe të Tashkistanit.

**Neni 3  
Dokumentet e bashkëngjitura**

Në anekset nr. 1 dhe 2 të këtij ligji është bashkëngjitur Marrëveshja Financiare “ISTISNA’A” dhe Marrëveshja për Agjencinë “ISTISNA’A”, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Islamike për Zhvillim për Financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, Rruga M2.

**Neni 4  
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-211  
31 korrik 2013**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-037-2013, datë 16.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**